



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

---

Numri i lëndës: 2022:009809

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05513184

P.nr.34/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Dega në Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari i vetëm gjykues Valon Hajdini, bashkëpunëtorja profesionale Sandra Fazliu procesmbajtësi - praktikanti Arbon Shala, në çështjen penale ndaj të pandehurit I.Ç., i akuzuar për veprat penale: Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.253/21, të datës 01.02.2022. Pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit fillestar në prezencën e palëve, prokurorit të shtetit në PTH në Mitrovicë Ajtene Zoni, të pandehurit I.Ç., mbrojtësit të tij caktuar sipas detyrës zyrtare Av.Belkize Berisha - Xhemajli. Gjykata pas përfundimit të shqyrtimit fillestar më 27.02.2024 të njëjtën ditë ka shpallur publikisht aktgjykimin, ndërsa më dt.27.03.2024 është përpiluar me shkrim ky:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurit:

I.Ç., nga i ati A., nëna H., e vajzerisë O., i lindur më datë..., në fshatin..., Komuna Skenderaj, ku edhe tani jeton, me numër personal..., shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar – baba i pesë (5) fëmijëve, gëzon statusin e veteranit të luftës aktualisht merr pension në shumën prej 170 euro, i gjendjes së dobët ekonomike.

SHPALLET FAJTOR

SEPSE:

Ekziston dyshimi i bazuar mirë se duke qenë i vetëdijshëm për veprimin e tij dhe pasojat e se njëjtës, me datë 14.08.2021 rreth orës 12:00, në rrugën..., në fshatin..., Komuna Skenderaj, ka përdorur armën në atë mënyrë që në oborrin e shtëpisë në adresën e cekur, e në shenjë gëzimi – ahengu për shkak të lindjes së nipit, ka shtënë në ajër 5 herë nga pistoleta e tipit “Sasilmaz”, prodhim turk, modeli B6, të kalibrit 9x19 mm, me numër serik T-1102-20E50507, viti i prodhimit 2020, duke e përdorur armën në kundërshtim me ligjin mbi armët të Republikës së Kosovës Nr.05/L-022, me ç’ rast, për shkak të trajtimit jo të duhur dhe pakujdesisë vetit i ka shkaktuar lëndim të gishtit të djathtë.

- Me këtë ka kryer veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

- Andaj, gjykata në bazë të neneve:1, 2, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 22, 38, 39, 46,47, 48, 49, 69, të KPRK-së, nenin 364, 365 dhe nenit 449 par. 1 dhe 2 pika 2.6, lidhur me nenin 452 par.1 të KPP-së, të pandehurit I.Ç., i

## SH Q I P T O N

I.DËNIM ME BURGIM TË KUSHTËZUAR në kohëzgjatje shtatë (7) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, me kusht që i pandehuri brenda periudhës kohore prej (1) një viti, /periudha e verifikimit/, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale të natyrës të njëjtë, apo më të rëndë.

V. Gjukata, në mbështetje të nenit 276 par.1 e 2 të KPP-së, si dhe nenit dhe 367 par.3 të Kodit NR.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, nxjerr këtë:

URDHËR - URDHËROHET konfiskimi i përhershëm i sendeve si në vijim:

Arma- e llojit pistoletë e llojit “pistoleta e tipit “Sasilmaz”, prodhim turk, modeli B6, të kalibrit 9x19 mm, me numër serik T-1102-20E50507, viti i prodhimit 2020, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi kjo armë të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, në bashkëpunimin me Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, pasi që të vërtetohet se kjo armë nuk është përdorur në ndonjë rast tjetër penal..

II.I pandehuri I.Ç. obligohet të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë paushallin gjyqësor në shumë prej 20 euro, si dhe shumën prej 20 euro në emër të Fondit për kompensimin e viktimave të krimit, në tërësi shumë prej dyzet (40.00) euro, të gjitha obligohet t'i paguaj në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. Pala të dëmtuar sipas aktakuzës nuk kishte.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.253/21, të datës 01.02.2022 pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë- Dega Skenderaj- Departamenti i përgjithshëm, ndaj të pandehurit I.Ç. për shkak të veprës penale : Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së.

Rrjedha e procedurës penale:

Duke qenë se në këtë çështje penale i pandehuri I.Ç. akuzohet për veprën penale-Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPPK-së, për të cilën veprë penale është paraparë dënimi me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe në bashkëpunim me Odën e avokatëve të Kosovës, meqë mbrojtja është e detyruar, gjykata duke vepruar në përputhje me nenin 56 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së, për mbrojtës sipas detyrës zyrtare me shpenzime publike të pandehurit i është caktuar Av.Belkize Berisha - Xhemajli nga Skenderaj.

Më 27.02.2024 Gjykata për këtë lëndë penale në kuadër të kompetencës lëndore e territoriale, gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar. Seanca është mbajtur në prezencën e palëve: Prokurorës së shtetit në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë Ajtene Zoni, të pandehurit I.Ç. si dhe mbrojtëses së tij sipas detyrës zyrtare Av.Belkize Berisha - Xhemajli.

I pandehuri I.Ç., në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur më 27.02.2024 pas njoftimit nga Gjykata lidhur me të drejtat e tij në këtë fazë të procedurës penale, dhe pasi që u konfirmua se i njëjti i kupton këto të drejta, i pandehuri është deklaruar se e pranon në tërësi fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet; Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga

neni 367 par.1 të KPRK-së, duke shtuar jam e vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe për pasojat dhe benifitet e pranimit të fajësisë, se i vije keq për rastin që ka ndodhur, i premtojë gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla.

Gjykata ka marrë mendimin e palëve në lidhje me deklarinimin mbi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe atë nga prokurorja e rastit Ajtene Zoni, e cili ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pranimi i fajësisë është bërë komfor dispozitave të nenit 242 të KPP-së, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare pas konsultimeve të mjaftueshme me avokatin mbrojtës, pranimi i fajësisë gjen mbështetje në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe materialët që janë pjesë përbërëse e shkresave të lëndës andaj, i propozoi gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtorë për veprën penale që i vihet në barrë dhe të njëjtit t'i shqiptojë sanksion penal me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit, ndërsa me rastin e matjës se llojit dhe lartësisë se dënimit si rrethanë lehtësuese ta marrë parasysh pranimin e fajësisë nga i pandehuri, sa i përket rrethanave rënduese të marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale dhe sjelljen e mëparshme të të pandehurit.

Mbrojtësja e të pandehurit av. Belkize Berisha - Xhemajli lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se, pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në mënyrë vullnetare, i njëjti përveç pranimit të fajësisë që ka bërë në polici dhënë me datë 09.09.2021, i njëjti e ka njoftuar policinë dhe asnjëherë me asnjë veprim nuk ka tëntuar t'i shmanget përgjegjësisë penale, përdorimi i armës ka ardhur si rezultat i emocioneve të pa kontrolluara të tij me rastin e gëzimit familjar për shkak të lindjes së nipit, i propozoi gjykatës që ta pranojë pranimin e fajësisë si rrethanë lehtësuese komfor dispozitave ligjore në fuqi dhe me rastin e shqiptimit të dënimit të marrë parasysh faktin se në këtë çështje penale nuk kemi asnjë rrethanë kualifikuese që do ta përkufizonte cilësimin juridik të veprës penale, që gjykata të marrë parasysh moshën e të akuzuarit si rrethanë të cilën po ashtu e parashohin dispozitat ligjore në fuqi, nga ana e mbrojtjes konsideroi se në rastin konkret janë plotësuar të gjitha kushtet për zbutjen e dënimit që parasheh Kodi Penal, pasi që edhe me një dënim nën minimumin e saj që është përcaktuar për këtë veprë penale do të arrihej qëllimi i dënimit ndaj të mbrojturit të saj.

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilin e ka deklaruar u pandehuri I.Ç. e në mbështetje të nenit 242 par.6, gjykata ka konsideruar se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata gjen se pranimi i fajësisë mbështetet në tërësi në provat që përmban aktakuza, siç janë: raporti i oficerit policor i datës 14.08.2021, raporti fillestar i

incidentit i datës 14.08.2021, raporti informues hetimor i datës 14.08.2021, procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitares B.Ç. të dhënë në hetuesi të datës 14.08.2021, procesverbalet e marrjes në pyetje të pandehurit I.Ç. të dhënë në hetuesi të datës 09.09.2021 dhe datë 25.01.2022, fletëlëshimi i datës 19.08.2021, në emër të të pandehurit I.Ç. lëshuar nga Qendra Klinike Unoversitare e Kosovës Klinika e Ortopedisë dhe Traumatologjisë Lokomotore Prishtinë, përmbajtja e dosjeve të forenzikës se bashku me foto albumet prej gjithsej gjashtë (6) faqe dhe pesëmbëdhjetë (15) faqe dhe zingjirit të ruajtjes një (1) faqet të datës 14.08.2021, vërtetimi për konfiskimin e armatimit dhe municionit i datës 14.08.2021, pëlqimi për blerjen e armës nga personi fizik i datës 14.05.2021, raporti i shitjes se armëve, pjesëve të tyre dhe municionit i datës 18.06.2021, certifikata për shënjimin e armëve e datës 20.03.2021, leja për armë shejtarie e datës 24.06.2021 e vlefshme deri me datë 24.06.2026, raporti i ekspertimit i datës 08.11.2021 dhe informacionet personale, andaj të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë në tërësi elementet inkriminuese e që në bazë të tyre dhe pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit, përtej çdo dyshimi vërtetohet se i njëjti ka kryer veprën penale; Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së.

Gjykata, gjen se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare dhe se ai e ka kuptuar natyrën pasojat dhe benifitet e pranimit të fajësisë.

Gjykata i kishte tërhequr vërejtjen të pandehurit se pas pranimit të fajësisë nuk mundet të shfrytëzojnë të drejtën në ankesë, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, i njëjti është njoftuar se nëse e pranon fajësinë humb mundësinë e kundërshtimit të provave në aktakuzë dhe mundësin për paraqitjen e provave të tjera, si dhe për faktin se pranimi i fajësisë sipas ligjit është rrethanë lehtësuese që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata mund të shqiptoj një dënim më të butë.

Gjykata ka vërtetuar se aktakuza në këtë rast nuk përmban asnjë shkelje ligjore e as gabim faktik dhe nuk ka bazë për hedhjen e akuzës.

Gjykata bazuar në pranimin e fajësisë prej të pandehurit dhe mbi bazën e provave të cekura si më lartë, përtej çdo dyshimi ka vërtetuar se i pandehuri I.Ç. është i përgjegjshëm dhe përgjegjës (fajtor) për veprat penale për të cilat akuzohet.

- Konfiskimi

Gjykata, në mbështetje të nenit 276 par.1 e 2 të KPP-së, si dhe nenit dhe 367 par.3 të Kodit NR.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, gjykata ka urdhëruar konfiskimin e përhershëm të armës “pistoleta e tipit “Sasilmaz”, prodhim turk, modeli B6, të kalibrit 9x19 mm, me numër serik T-1102-20E50507, viti i prodhimit 2020, pasi të vërtetohet se e njëjta nuk është përdorur në ndonjë rast tjetër penal, e po ashtu i njëjti armën e kishte përdorur në kundërshtim me ligjin, edhe pse posedonte leje me të njëjtën kishte shtënë në ajër në oborrin e shtëpisë së tij.

#### -Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit

Gjykata, lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, për të pandehurin I.Ç., ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 të KPRK-ës, gjykata ka marrë për bazë faktin se i njëjti ka treguar sjellje të mira dhe paraqitje serioze në gjykatë në raport me gjykatën, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë për ndonjë veprë tjetër penale, më parë ka qenë i pa dënuar, pendimin e sinqertë, i njëjti është baba i pesë (5) fëmijëve, është i gjendjes së dobët ekonomike, ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese për të pandehurin gjykata ka marrë pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale për të cilën akuzohet, gjë që ka ndikuar që së bashku me rrethanat tjera, që gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit ti marrë për bazë dhe ka kushtëzuar dënimin e shqiptuar që i njëjti të mos ekzekutohet, kurse si rrethana rënduese gjykata ka marrë për bazë shkallën e përgjegjësisë penale të tij, si dhe faktin se veprat penale të kësaj natyre çdo ditë janë në rritje e sipër.

Gjykata vlerëson se një dënim i tillë i shqiptuar ndaj të pandehurit I.Ç. në raport me shkallën e përgjegjësisë, rrezikshmërinë e veprës penale, moshën e të pandehurit dhe rrethanat e tjera që i kemi cekur më lartë është adekuat dhe ne si gjykatë jemi plotësisht të bindur se do të arrihet qëllimi i dënimit në raport me të pandehurin por edhe në raport me personat e tjerë, që në të ardhmen të përmbahen nga sjelljet që cenojnë rendin dhe ligjin.

#### -Shpenzimet e procedurës penale

Duke u bazuar në nenin 449 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPPK-së, gjykata ka përcaktuar shpenzimet procedurale në shumën prej (20) njëzet euro dhe (20) njëzet në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit, në total prej (40) katërdhjetë euro.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 364 dhe 369 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA SKENDERAJ**

Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal

P.nr.34/2022 të datës 27.03.2024.

Procesmbajtësi,  
Arbon Shala

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Valon Hajdini

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa i drejtohet gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për gjykatën.